

# E drejta për informim

## Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

### Fokusi i muajit

#### Procedura e shqyrtimit të ankesave

Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara në ligjin nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.

Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur:

- ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit;
- ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.

Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ia kalon atë strukturës që merret me të drejtën e informimit. Struktura përkatëse "Drejtoria e Vlerësimit të Ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit" verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës.

Për këtë qëllim, Zyra e Komisionerit mund t'u kërkojë ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër. Kur e sheh të nevojshme, Komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi.

### Përmbledhje mujore e vendimeve dhe rekomandimeve

**Vendim Nr. 38** - Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë

**Vendim Nr. 39** - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

**Vendim Nr. 40** - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

**Vendim Nr. 42** - Micro Credit Albania

**Vendim Nr. 43** - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

# Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), gjatë muajit gusht, ka dhënë pesë vendime urdhërimi në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI).

Me anë të Vendimit nr. 38, datë 12.05.2021, KDIMDP ka pranuar ankesën për refuzim dhënie informacioni ndaj Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë (Autoriteti Publik) ku kërkohet statistika mbi:

- Numrin aktual (viti 2021) të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë;
- Raporti aktual mes numrit të gjyqtarëve dhe numrit të çështjeve për gjykim (ngarkesa e punës për secilin gjyqtar);
- Numrin e gjyqtarëve në vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020.
- Raporti i numrit të gjyqtarëve dhe numrit të çështjeve për gjykim (ngarkesa e punës për secilin gjyqtar), ndër vite;
- Kohëzgjatja aktuale (viti 2021) dhe sa ka qenë në vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 kohëzgjatja mesatare e një gjykimi;
- Numri i gjyqtarëve të shkarkuar si pasojë e procesit kalimtar të rivlerësimit (Vetting-ut);
- Numri i çështjeve gjyqësore që janë kaluar një gjyqtari tjetër, kur gjyqtari i ngarkuar i çështjes nuk ka mundur të kalojë procesin kalimtar të rivlerësimit (Vetting-un);
- Nevoja për shtesë burimesh njerëzore (gjyqtarë) në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë;
- Numrin e çështjeve që janë gjykuar nga gjyqtarë të deleguar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë gjatë viteve 2016, 2017, 2018, e 2019, 2020 dhe 2021;
- Vlëra e përllogaritur (vlëra financiare) për rekrutimin e burimeve të nevojshme njerëzore (gjyqtarë) në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE  
PUBLIKE ËSHTË PARADHOMA  
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI WWW.IDP.AL

## #informim #transparencë #vendim

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjor

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar lidhet me të dhëna të cilat krijohen në përmbushje të detyrave ligjore të Autoritetit Publik. Në këto kushte informacioni i kërkuar në parim përbën informacion publik në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të LDI, në të cilën parashikohet se, "informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit".

Në përfundim të procesit administrativ të shqyrtimit të ankesave, KDIMDP vendosi urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënie e informacionit të kërkuar në të gjitha pikat e kërkesës.

Në vendimarrjen e tij, Zyra e Komisionerit informon palët për të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP [www.idp.al](http://www.idp.al).

# Raport paraprak mbi transparencën e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Në zbatim të detyrave funksionale të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë vitit 2021 është monitoruar zbatimi i Programit të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore sipas urdhrorit nr. 211 datë 10.09.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Në periudhën janar - gusht 2021, Zyra e Komisionerit ka dhënë 32 rekomandime për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore me qëllim zbatimin e Programit Model të Transparencës sipas urdhrorit të sipërcituar.

Edhe gjatë vitit të kaluar Zyra e Komisionerit vendosi 17 Rekomandime për njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat e kishin vënë në zbatimin Programin e Transparencës por të cilat kishin mangësi në publikimin e informacionit si dhe vendosi 3 Vendime me sanksion gjobe për ato njësi të vetëqeverisjes vendore të cilat nuk e kishin publikuar programin model të transparencës.


Me qëllim verifikimin e rekomandimeve të dhëna, Zyra e Komisionerit ka zhvilluar 20 inspektime pranë Njësive të Vetëqeverisjes Vendore. Në vazhdim, Zyra e Komisionerit do të përmbyll procesin e verifikimit të rekomandimeve dhe në rast të mospërmbushjes së detyrimeve do të vijojë sipas parashikimeve të neneve 18, 19 dhe 20 të ligjit nr.11/2014 "Për të drejtën e informimit".

REKOMANDIME 2021	
Legjislacion	Rekomandim Nr. 2 - Bashkia Libohovë
Programi model i Transparencës për Autoritetet Publike	Rekomandim Nr. 3 - Bashkia Memaliaj
Programi model i Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore	Rekomandim Nr. 4 - Bashkia Përmet
► Për Individin	Rekomandim Nr. 5 - Bashkia Kuçovë
► Për Autoritetin Publik	Rekomandim Nr. 6 - Bashkia Has
Vendime/Rekomandime	Rekomandim Nr. 7 - Bashkia Pustec
	Rekomandim Nr. 8 - Bashkia Sarandë
	Rekomandim Nr. 9 - Bashkia Kavajë
	Rekomandim Nr. 10 - Bashkia Fushë Arrëz
	Rekomandim Nr. 11 - Bashkia Këlcyre
	Rekomandim Nr. 12 - Bashkia Konispol
	Rekomandim Nr. 19 - Bashkia Tepelene
	Rekomandim Nr. 20 - Bashkia Prrenjas
	Rekomandim Nr. 21 - Bashkia Vorë
	Rekomandim Nr. 23 - Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
	Rekomandim Nr. 26 - Bashkia Klos
	Rekomandim Nr. 27 - Bashkia Vlorë
	Rekomandim Nr. 28 - Bashkia Lezhë
	Rekomandim Nr. 35 - Bashkia Mat
	Rekomandim Nr. 36 - Bashkia Bulqizë

# ICIC - INFORMATION COMMISSIONERS YOUTUBE CHANNEL

Në kuadër të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC), e cila u organizua online nga autoriteti i Brazilit në 23-24 qershor 2021, ICIC ka programuar zhvillimin e aktivitete paralele përgjatë vitit të cilat lidhen me fushën e të drejtës për informim.

Disa prej këtyre evente, janë të hapura për publikun dhe mund të ndiqen online nëpërmjet kanalit të YouTube të ICIC duke ndjekur kanalin "ICIC - Information Commissioners".



...ries in access to information. ...cess to Information and Free... and Trust in Pandemic Times

**Blanca Lilia Ibarra Cadena**  
Comisionada Presidenta INAI

**prensa usa las leyes de acceso a la información**

Cuáles son las motivaciones de un periodista para usar las leyes de acceso a la información?

- La posibilidad de contrastar o verificar la información.
- La posibilidad de develar escándalos de corrupción.
- Procesar información cruda.

Los medios tienen la posibilidad de construir su propia agenda de investigación

**Obstáculos:**

- Tiempos de respuesta
- Falta de Capacitación
- Inexistencia de información